

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
PRISHTINË

Numri i lëndës: PML-KZZ-242/15

Data: 26 nëntor 2015

Gjykata Themelore: Prishtinë, PKR nr 18/15

Gjykata Supreme e Kosovës, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarja e EULEX-it Elka Filcheva-Ermenkova, si kryetare e kolegjit dhe gjyqtare referuese, gjyqtari i EULEX-it Dariusz Sielicki, dhe gjyqtari i Gjykatës Supreme Avdi Dinaj, si anëtarë të kolegjit, të ndihmuar nga Adnan Isufi, këshilltar ligjor i EULEX, në cilësi të procesmbajtësit, në lëndën penale kundër të pandehurve:

ET

ML

DP

AG

HH

AD

SL

ET

ML

Të akuzuar për kryerje të pretenduar të veprave penale në vijim: të pandehurit [REDACTED] dhe [REDACTED] për veprat penale të mashtrimit dhe falsifikimit të dokumenteve në bashkëkryerje, në shkelje të nenit 335 paragrafëve 1 dhe 5 dhe nenit 398 paragrafit 1 lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (tash e tutje "KPRK"); [REDACTED] për veprën

DP

Lënda kthehet në Gjykatën Themelore të Prishtinës që të procedohet në përputhshmëri.

ARSYETIMI

I. HISTORIA E PROCEDURËS

1. Kjo lëndë ka të bëjë me një proces të tenderimit për shërbime të sigurimit të zhvilluar nga Korporata Energjetike e Kosovës SH.A. ("KEK") më 2012. Pretendohet se sjellja e paligjshme e të pandehurve ka rezultuar me dhënien e kontratës kompanisë së sigurimit "Security Code", e cila ka ofertuar si pjesë e konzorciumit, kompania dhe (konzorciumi) WDG, në procesin e tenderimit. Kontrata në fjalë ishte për periudhën dy vjeçare në shumë prej of € 6, 182,609.76, një shumë për të cilën pretendohet se është dëmtuar KEK-u.

2. Më 5 tetor 2012, prokurori ka lëshuar një aktvendim për nisjen e hetimit kundër të pandehurve [REDACTED], [REDACTED], [REDACTED] dhe [REDACTED] për kryerje të pretenduar të veprës penale keqpërdorimi pozitës zyrtare ose i autorizimit, në shkelje të nenit 339 paragrafëve 1, 2 dhe 3 të Kodit Penal të Kosovës (tash e tutje "KPK").

3. Më 15 mars 2013, prokurori ka zgjeruar hetimin duke përfshirë të pandehurin [REDACTED] në lidhje me veprën e pretenduar penale keqpërdorimi pozitës zyrtare ose i autorizimit, në shkelje të nenit 422 paragrafëve 1, 2 dhe 3 të KPRK-së. Prokurori po ashtu zgjeroi hetimin duke përfshirë edhe veprat e pretenduara penale mashtrim dhe falsifikim i dokumenteve kundër të pandehurve [REDACTED] dhe [REDACTED] dhe për veprën penale lidhja e kontratës së dëmshme në shkelje të nenit 192 paragrafëve 1 dhe 2 KPK-së kundër të pandehurit [REDACTED]. Prokurori e ri cilësoi veprën e pretenduar penale keqpërdorimi pozitës zyrtare ose i autorizimit në shkelje të nenit 339 paragrafëve 1, 2 dhe 3 të KPK-së në një veprë të ngjashme penale por në kundërshtim të nenit 422 paragrafëve 1, 2 dhe 3 of the KPRK-së kundër të pandehurve [REDACTED] dhe [REDACTED].

4. Hetimet ishin zgjeruar prapë më 12 nëntor 2015 përkatësisht më 10 prill 2014, kundër të pandehurve [REDACTED] dhe [REDACTED] për veprën e pretenduar penale shtytje për keqpërdorim të pozitës zyrtare ose të autorizimit, në shkelje të nenit 422 paragrafëve 1 dhe 2 të KPRK-së.

5. Më 20 nëntor 2014, prokurori paraqiti propozim për vazhdimin e afatit të hetimit i cili do të skadonte më 4 tetor 2014.

6. Më 16 dhjetor 2014, gjyqtari i procedurës paraprake vazhdoi në mënyrë retroaktive afatin e hetimit kundër të pandehurve [REDACTED] [REDACTED] [REDACTED] [REDACTED] dhe [REDACTED] deri më 16 janar 2015. Me anë të aktvendimit të njëjtë, gjyqtari i procedurës paraprake refuzoi të vazhdojë afatin e hetimit sa i përket të pandehurve [REDACTED] dhe [REDACTED] me pohimin se kërkesa e prokurorit ishte e parakohshme përkitazi me këtë.

AD

ML

ET

DP

HH

AG

SL

AD

7. Më 17 mars 2015, Gjykata e Apelit pranoi ankesat e avokatëve mbrojtës të të pandehurve [REDACTED] dhe [REDACTED] kundër aktvendimit të gjyqtarit të procedurës paraprake të datës 16 dhjetor 2014, duke mbështetur se afati i hetimit ka skaduar më 5 tetor 2014.

##

8. Më 16 janar 2015, prokurori ngriti aktakuzë dhe më 10 janar 2015 u mbajt shqyrtimi fillestar në këtë çështje penale. Gjatë zhvillimit të shqyrtimit fillestar avokati mbrojtës paraqiti kundërshtimet ndaj provave dhe kërkoi që aktakuza të hedhet poshtë.
9. Më 11 qershor 2015, gjykata e shkallës së parë i refuzoi kundërshtimet e avokatëve mbrojtës sa i përket provave dhe hedhjes poshtë të aktakuzës, dhe e konfirmoi aktakuzën.
10. Më 5 gusht 2015, Gjykata e Apelit duke vendosur lidhur me ankesat e avokatëve mbrojtës kundër aktvendimit të gjykatës së shkallës së parë të datës 11 qershor 2015, pranoi pjesërisht ankesat dhe hodhi poshtë aktakuzën si të paafatshme.
11. Gjykata e Apelit i refuzoi si të pabazuara pretendimet kundër gjetjeve të provave. Aktvendimi nuk është kundërshtuar në pjesën e dytë të tij. Prandaj, Gjykata Supreme nuk ka nevojë të shtjellojë as për pranueshmërinë e as për meritat e kërkesës së tillë hipotetike.
12. Në kërkesën e tij, prokurori ka formuluar disa *petitume* të ndryshme (infra paragraf 21) prandaj është me rëndësi të sqarohet se aktvendimi i kundërshtuar është mbështetur në premisën se koha për hetime nuk mund të vazhdohet pas përfundimit të vitit të dytë, sepse hetimi tanimë ka përfunduar *ex-lege* (shih faqen 8 të aktvendimit të kundërshtuar).
13. Më 9 shtator 2015, prokurori i EULEX-it Claudio Pala nga Zyra e Prokurorit të Shtetit të Republikës së Kosovës ka paraqitur kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit të datës 5 gusht 2015.

14. Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë u është dorëzuar të pandehurve dhe avokatëve të tyre mbrojtës.

15. Përgjigje kanë paraqitur avokati mbrojtës, [AQ] [RG] [AK] [ML] [AG] [AD] [SB] avokati mbrojtës [redacted] përfaqësues i të pandehurit [redacted] avokati mbrojtës [redacted] përfaqësues i të pandehurit [redacted] avokati mbrojtës [redacted] përfaqësues i të pandehurit [redacted] avokati mbrojtës [redacted] përfaqësues i të pandehurit [redacted] Avokati mbrojtës [redacted] më vonë ka paraqitur plotësim të përgjigjes së tij fillestare ndaj kërkeses për mbrojtje të ligjshmërisë. [MN] [HH] [ET] [AK]

II. Parashtrësit e palëve

A. Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e prokurorit publik

16. Në përmbledhje prokurori thirret në shkelej të nenit 159 paragrafit I të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (tash e tutje "KPPK") me pretendim se Gjykata e Apelit ka arritur gabimisht në përfundim se skadimi i afatit të hetimit pamundëson ngritjen e aktakuzës. Më tutje prokurori shtjellon lidhur me sistemin e KPPK-së sa i përket fazave të ndryshme të procedurës penale siç specifikohet në nenin 68 *ibid*. Prokurori po ashtu shtjellon lidhur me çështjen se a mund të paraqitet kërkesë për vazhdim të hetimit pas përfundimit të afatit kohor dy vjeçar sipas nenit 159 paragrafit I *ibid*. Prokurori pohon se mekanizmi për vazhdimin siguron fleksibilitet i cili i limiton situatat përtej kontrollit të prokurorit, duke arritur në përfundim se në fund të fundit propozimi për vazhdim do të jetë prapëseprapë i pranueshëm edhe nëse paraqitet pas skadimit të afatit dyvjeçar, përderisa gjyqtari i procedurës paraprake përcakton se ende është i pranueshëm nën rolin e tij/saj sipas nenit 245 et seq., si në këtë rast (më parë gjyqtari i procedurës paraprake vazhdoi hetimin në bazë të propozimit të prokurorit, të paraqitur pas skadimit të afatit dyvjeçar), por në aktvendimin e kundërshtuar Gjykata e Apelit përqafton një pikëpamje të kundërt, siç është përmendur tanimë *më lart*, paragrafi 12. Përveç kësaj, prokurori pretendon se aktvendimi i kundërshtuar është në kundërshtim me praktikën e mëhershme të gjykatave. Kërkesa pretendon se aktvendimi i kundërshtuar nuk ka arritur të japë një interpretim adekuat të ligjit, duke përmbajtur vetëm arsyetim themelor.
17. Prokurori pajtohet me pohimin e Gjykatës së Apelit se nën rrethana normale propozimi me të cilin kërkohet kohë shtesë për zhvillimin e hetimit duhet të paraqitet para skadimit të afatit të caktuar fillimisht. Megjithatë, siç u përmend, gjyqtari i procedurës paraprake është në pozitën më të mirë për të përcaktuar nëse vonesa për paraqitjen e kërkesës për vazhdimin e hetimit ishte e arsyeshme. Lista e faktorëve për t'u marrë parasysh si faktorë të arsyeshëm për vonesë në paraqitjen e propozimit për vazhdimin e hetimit është medoemos e pakufishme. Ka shumë faktorë që duhet të vlerësohen për secilën lëndë

veçmas, ku i takon gjyqtarit të procedurës paraprake të bëjë balancimin e çdo dëmi të mundshëm të shkaktuar nga paraqitja e parakohshme, me faktorët atë që rezultojnë në mbrojtje të dobët të ligjit dhe të rendit në shoqëri.

18. Sa i përket kohës së caktuar për hetim në rast të vazhdimit të hetimit, prokurori parashtron se praktika e gjertanishme e ngurtë e gjykatave ishte që çdo vazhdim i hetimit të trajtohej si rinisje e kohës së caktuar në lidhje me një vepër të re penale dhe/ose të dyshuar.
19. Për sa i përket afatit kohor të ngritjen e aktakuzës, prokurori parashtron se interpretimi i Gjykatës së Apelit i nenit 159 të KPP-së ishte njësoj i ngurtë. Prokurori pretendon se asnjë dispozitë e KPP-së nuk e parandalon prokurorinë të ngreh aktakuzë pas skadimit të afatit të hetimit dhe deri në skadimin e parashkrimit të veprës penale. Sipas prokurorit, skadimi i afatit të hetimit vetëm shënon *ex lege* përfundimin e fazës së hetimit, kurse procedura penale (ku hetimi është vetëm një faze e saj) përfundon vetëm me anë të vendimit gjyqësor të formës së prerë siç mund të konkludohet edhe me nenin 4 paragrafin 1 të KPP-së. Prokurori parashtron se neni 103 i KPP-së vetëm përcakton rregullat e veprimeve të hetimit dhe prandaj nuk është i lidhur me ngritjen e aktakuzës e cila mund të vjen më vonë. Sipas nenit 240 të KPP-së aktakuza mund të ngrihet "pas përfundimit të hetimit" dhe ku mund të konkludohet se ngritja e aktakuzës nuk është veprim hetimor. Prokurori pretendon se analiza e Gjykatës Themelore sa a është e arsyeshme vonesa në një rast specifik, siguron që të drejtat e të pandehurit të mbrohet në masë të mjaftueshme. Sipas prokurorit, vonesa thjesht e aktakuzës është parashikuar në kodin e procedurës as si kategori ligjore e as si rrethanë që ndalon prokurorinë dhe që e detyron hedhjen poshtë të aktakuzës.
20. Prokurori i cilësoi kundërshtimet që i bëri si shkelje substanciale të dispozitave të KPPK-së në përputhje me nenin 384 paragrafin 1, nën-paragrafin 12 lidhur me nenin 370 të KPP-së; dhe me nenin 384 paragrafin 2, nën-paragrafin 1, lidhur me nenin 103 paragrafin 4, nenet 159, 253, 358 paragrafin 1.3 dhe 416 të KPP-së.
21. Prokurori propozon që Gjykata Supreme:
 - të shpall se aktvendimi i kundërshtuar ka bërë shkelje të dispozitave të nenit 384 paragrafit 1, nën-paragrafit 12 lidhur me nenin 370 të KPPK-së; sa i përket nevojës se vendimi i gjyqtarit duhet të përmbajë një arsyetim adekuat;
 - të ri konfirmojë parimet tashmë të shprehura në juridiksion se propozimi për vazhdimin e hetimit mund të paraqitet ligjërisht pas afatit të caktuar fillimisht për hetim me nenin 159 të KPPK-së, se çdo zgjerim i hetimit rezultojnë me rinisjen e afatit kohor të caktuar për hetim në lidhje me një vepër të re penale dhe/ose të dyshuar, se aktakuza mund të ngrehet ligjërisht edhe pas skadimit të afatit kohor të caktuar për hetim me nenin 159 të KPPK-së, përderisa kjo vonesë është e arsyeshme;

-dhe si përfundim të shpall se aktvendimi i kundërshtuar ka bërë shkelje të dispozitave të nenit 384 paragrafit 2, nën-paragrafit 1, lidhur me nenin 103 paragrafin 4, nenet 159, 253, 358 paragrafin 1.3 dhe 416 të KPK-së.

B. Përgjigjet e avokatëve mbrojtës

22. Avokati mbrojtës, RQ [redacted] përfaqësues i të pandehurit RQ [redacted] i propozon Gjykatës Supreme ta refuzojë kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë si të pabazuar. Avokati mbrojtës RQ [redacted] i referohet nenit 438 paragrafit 2 dhe nenit 432 të KPPK-së duke pretenduar se kërkesa është në kundërshtim me bazat për të cilat mund të paraqitet kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë. Avokati mbrojtës pohon se pretendimi i prokurorit se çdo zgjerim i hetimit, automatikisht, nënkupton edhe rinisje e afatit kohor ose se prokurori mund të ngreh aktakuzë pas përfundimit të hetimit është në kundërshtim me përmbajtjen e dispozitës së nenit 159 të KPP-së. AG
23. Avokati mbrojtës SB [redacted] përfaqësues i të pandehurit HH [redacted] parashtrohet se kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është e pabazuar. Avokati mbrojtës thekson se prokurori vetëm i referohet rasteve të tjera. Mirëpo, praktika gjyqësore në Kosovë nuk është burim i ligjit, përkatësisht, nuk është ligjërishit detyruese. Avokati mbrojtës pohon se shembujt të cilëve iu referohet prokurori datojnë prapa në kohën kur ishte në fuqi Kodi i vjetër Penal dhe ai i Procedurës Penale. Prandaj, avokati mbrojtës i propozon gjykatës që ta refuzojë kërkesën si të pabazuar. ET
24. Avokati mbrojtës MN [redacted] përfaqësues i të pandehurit ET [redacted] i propozon gjykatës që ta refuzojë kërkesën si të pabazuar. Avokati mbrojtës pohon se Gjykata e Apelit ka ofruar arsytim të mjaftueshëm për çështjet e ngritura nga prokurori në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë. Avokati mbrojtës parashtrohet se prokuroria duhet të veprjë brenda afateve ligjore. Po që se lënda është e ndërlikuar, prokuroria duhet të kërkojë kohë shtesë. Sipas avokatit mbrojtës, prokurori i ka dy opsione, ose të ngreh aktakuzë ose të kërkojë nga gjykata vazhdim të kohës së hetimit. Në rastin konkret, avokati mbrojtës pohon se prokurori nuk ka vepruar në asnjërën mënyrë. ML
25. Avokati mbrojtës AQ [redacted] përfaqësues i të pandehurit ML [redacted] propozon gjykatës që ta refuzojë kërkesën si të pabazuar dhe ta konfirmojë aktvendimin e kundërshtuar. Avokati mbrojtës pretendon se dispozitat e dykuptimshme, nëse janë të tilla, siç pretendon prokurori, duhet të interpretohen në favor të të pandehurit. Të pandehurit nuk duhet t'i nënshtrohen kufizimit të të drejtave të tyre dhe siguria e tyre juridike nuk duhet të dëmtohet. Avokati mbrojtës pretendon se hetimi nuk mund të vazhdohet përtej afatit të përcaktuar pavarësisht faktit nëse hetimi është zgjeruar për një veprë të re penale ose kundër një të pandehuri të ri. Përndryshe, avokati mbrojtës pohon se, një person nuk mund të nën hetime thjesht vetëm sepse hetimi nuk ka përfunduar për të pandehurit e tjerë. Avokati mbrojtës parashtrohet se gjykata duhet të parandalojë prolongimet e hetimit nga

palët në procedurë dhe/ose nga shpërdorimi i autorizimeve, në rastin kur kjo vlen për prokurorin. Avokati mbrojtës pohon se pas skadimit të afatit dyvjeçar, prokurori është dashur ta lëshojë një aktvendim për përfundimin e hetimit. Kundër këtij aktvendimi nuk do të mund të paraqitet ankesë. Mjeti i vetëm juridik në dispozicion i cili do të mund të përdorej në rast të tillë kur procedura penale është hedhur poshtë para shqyrtimit gjyqësor, është kërkesa për rishikimin e procedurës, nëse janë përmbushur kriteret tjera *p.sh.*, keqpërdorimi i detyrës zyrtare nga prokurori publik. Sidoqoftë, në këtë lëndë nuk bëhet fjalë për këtë. Avokati mbrojtës thekson se sipas nenit 159, hetimi ndërpritet pas dy viteve nga fillimi i hetimit. Kjo do të thotë, sipas avokatit mbrojtës se aktakuza duhet të ngitet para skadimit të hetimit. Avokati mbrojtës i referohet mendimit juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës të datës 19 janar 2015, ku thuhet se ngritja e aktakuzës pas skadimit të afatit ligjor të përcaktuar me nenin 159, është veprim i kundërligjshëm pasi që ligji e obligon përfundimin e procedurës.

AK

AD

26. Avokati mbrojtës [REDACTED] i cili përfaqëson të pandehurin [REDACTED] [REDACTED] i propozon Gjykatës Supreme të Kosovës që ta refuzojë kërkesën për morojtje të ligjshmërisë si të pabazuar. Avokati mbrojtës pretendon se kërkesa është në shkelje të dispozitave të Kodit të Procedurës Penale, Kodit Penal, Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Avokati mbrojtës pretendon në shkelje të nenit 432 (3) të KPP-së sepse kërkesa mund të paraqitet nga Prokurori i Shtetit të Republikës së Kosovës dhe jo nga prokurori i EULEX-it. Avokati mbrojtës pretendon në shkelje të nenit 4 të KPP-së, përkatësisht, parimit *ne bis in idem*, i cili përcakton se askush nuk mund të ndiqet dhe të dënohet për veprë penale nëse është liruar ose për të cilën është dënuar me vendim të formës së prerë, përkatësisht nëse procedura penale kundër tij është pushuar me vendim të formës së prerë të gjykatës. Avokati mbrojtës pohon se sipas nenit 3 (2) të KPP-së, mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen ose për zbatimin e ndonjë dispozite të ligjit penal interpretohen në favor të të pandehurit. Avokati mbrojtës pretendon se, në lëndën në fjalë, hetimi ka skaduar më 4 tetor 2014, kurse aktakuza është ngritur më 16 janar 2015. Neni 159 (1) i KPP-së, përcakton se nëse aktakuza nuk ngritet brenda dy viteve nga fillimi i hetimit, hetimi ndërpritet automatikisht. Avokati mbrojtës pretendon se afati është i karakterit prekluziv dhe nuk mund të vazhdohet. Avokati mbrojtës pohon se prokurori ka dështuar që ta ngrit aktakuzën me kohë. Duke u ballafaquar me këtë situatë, më 20 ose më 24 nëntor 2014, Prokuroria ka paraqitur kërkesë për vazhdimin e hetimit (rreth 40 ditë pas skadimit të afatit të hetimit) në mënyrë që të përdorë vazhdimin për ta tejkaluar dështimin e prokurorit për ta ngritur aktakuzën brenda afatit. Më tutje, avokati mbrojtës pretendon në kundërtënie në kërkesat e prokurorit të cilat nuk përmbajnë datë të protokollit. Kërkesa për vazhdimin e hetimit nuk i ishin dorëzuar mbrojtjes, prandaj mbrojtja parashtrohet se, duhet të konsiderohen si dokument i pavlefshëm. Avokati mbrojtës gjithashtu thekson se prokurori ka dështuar që ta pranojë karakterin detyrues të mendimeve të Gjykatës Supreme të Kosovës. Avokati mbrojtës i referohet një numri të aktvendimeve, të bashkangjitura si shtojca, të lëshuara nga gjykatat në Kosovë përkitazi me këtë. Më tutje, avokati mbrojtës shtjellon në detaje zhvillimin e procedurës në shkallën e parë. Avokati mbrojtës pretendon se gjykata e shkallës së parë ka dështuar që ta mbajë shqyrtimin e dytë në këtë lëndë ku do

të sqaroheshin çështjet e ngritura nga Prokurori dhe mbrojtja. Avokati mbrojtës thekson se klienti i tij nuk është deklaruar i fajshëm. Avokati mbrojtës pretendon se aktakuza është e pasaktë, se autoriteti i Prokurorisë ka shkelur të drejtat e klientit të tij për jetë private duke përgjuar komunikimin me gruan e tij. Më tutje, avokati mbrojtës pretendon në shkelje të parimit të ligjit penal *nullum crimem nulla poena sine lege* sa i përket cilësimit të veprës penale etj.

III. Procedura para Gjykatës Supreme të Kosovës:

1. Gjykata Supreme e Kosovës është kompetente për të vendosur lidhur me kërkesën [Neni 435 CPC].
2. Gjykata Supreme e Kosovës ka vendosur në seancë të këshillimit dhe votimit. Njoftimi i palëve për këtë seancë nuk ka qenë i domosdoshëm.

IV. Shkeljet e Gjykatës Supreme të Kosovës

A. Pranueshmëria e kërkesës

27. Gjykata Supreme e Kosovës nuk ka gjetur asnjë gabim procedural në aktvendimin e kundërshtuar të cilin do të duhet ta merrte parasysh sipas detyrës zyrtare. Sipas dispozitave të KPPK-së, Gjykata Supreme e Kosovës do të kufizohet në shqyrtimin e vetëm atyre shkeljeve të cilat pala i ka pretenduar në kërkesën e tij.
28. Gjykata Supreme së pari ka ekzaminuar nëse paraqitësi i kërkesës është palë e autorizuar për të paraqitur kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë pranë gjykatës, në pajtim me kushtet e KPP-së.

Lidhur me këtë, neni 432 i KPP-së përcakton:

1. Kundër vendimit gjyqësor të formës së prerë ose kundër procedurës gjyqësore e cila i ka paraprirë marrjes së vendimit të tillë, pas përfundimit të procedurës penale në formë të prerë mund të paraqitet kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë në rastet vijuese:

1.1. në rast të shkeljes së ligjit penal;

1.2. në rast të shkeljes esenciale të ligjit të procedurës penale nga neni 384, paragrafi 1. i këtij Kodi; ose

1.3. në rast të shkeljeve të tjera të dispozitave të procedurës penale kur shkeljet e tilla kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor.

2. Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk mund të ushtrohet për shkak të konstatimit të gabueshëm ose jo të plotë të gjendjes faktike, as kundër vendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës me të cilën është vendosur mbi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë.

3. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 1. të këtij neni, Kryeprokurori i Shtetit mund të

paraqesë kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë për cilëndo shkelje ligjore.

Më tutje, neni 433 i KPP-së përcakton:

- 1. Kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë mund të paraqesë Kryeprokurori i Shtetit, i pandehuri dhe mbrojtësi i tij. Pas vdekjes së të pandehurit, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në emër të tij mund të paraqesin personat e paraparë në nenin 424, paragrafi 1. fjalë e fundit e këtij Kodi.*
 - 2. Kryeprokurori i shtetit, i pandehuri, mbrojtësi i tij dhe personat e paraparë në nenin 424, paragrafi 1. fjalë e fundit e këtij Kodi mund të paraqesin kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë brenda tre (3) muajve nga dita kur të pandehurit i është dorëzuar vendimi gjyqësor i formës së prerë. Nëse kundër vendimit të gjykatës themelore nuk paraqitet ankesë, afati rrjedh nga dita kur vendimi merr formë të prerë.*
 - 3. Kur me vendim të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut është vërtetuar se me vendim përfundimtar janë shkelur të drejtat e njeriut në dëm të të pandehurit, afati për paraqitjen e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë rrjedh nga dita kur vendimi i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut i dorëzohet të pandehurit.*
 - 4. Pavarësisht nga dispozitat e nenit 432, paragrafi 2. i këtij Kodi, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë nga paragrafi 3. i këtij neni mund të paraqitet edhe kundër vendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës.*
29. Pas shqyrtimit të aktvendimit të kundërshtuar, kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë dhe përgjigjeve të avokatëve mbrojtës, Gjykata Supreme e Kosovës konstaton se kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është e pranueshme. Kolegji gjen se kërkesa është paraqitur nga personi i autorizuar sipas nenit 433 *ibid*. Neni 11 paragrafi 1 nën-paragrafi 4 i Ligjit për Prokurorin e Shtetit nr.03/L-225, siç është ndryshuar, përcakton se “Kryeprokurori i Shtetit ka juridiksion ekskluziv mbi lëndët në shkallë të tretë pranë Gjykatës Supreme”. Funkcionet prokuroriale në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit kryhen nga Kryeprokurori i Shtetit dhe prokurorët në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit në pajtim me legjislacionin përkatës në fuqi. Kolegji gjen se në lëndën në fjalë, prokurori i cili ka parashtruar kërkesën është caktuar për lëndët në shkallën e Gjykatës Supreme dhe është kompetent për të paraqitur kërkesë.
30. Kolegji gjen se kërkesa është paraqitur kundër vendimit të formës së prerë dhe prandaj është e pranueshme sipas nenit 432 *ibid*. Forma e prerë e aktvendimit është vërtetuar me faktin se ka ndërprerë procedurën në formë të prerë.
31. Kolegji gjen se kërkesa gjithashtu është paraqitur me kohë, prandaj është e pranueshme sipas nenit 433 paragrafit 2 të KPP-së.

B. Çështjet ligjore

32. Pas shqyrtimit të aktvendimit të kundërshtuar, kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë dhe përgjigjeve të avokatëve mbrojtës, Gjykata Supreme e Kosovës me shumicë votash ka gjetur se kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është e bazuar.

33. Fillimisht, Gjykata Supreme e Kosovës vëren se prokurori në kërkesën e tij për mbrojtje të ligjshmërisë nuk ka kërkuar vetëm ndryshimin/anulimin e aktvendimit të kundërshtuar me të cilin përfundohet procedura penale apo shpalljen e tij të kundërligjshëm (në formulimin e përdorur nga prokurori), pasi që shkel dispozita të caktuara të KPPK-së, por prokurori gjithashtu ka kërkuar nga Gjykata Supreme që t'i përgjigjet në përgjithësi pyetjeve të formuluar në pikën 21 të këtij aktvendimi. Ky kolegji i Gjykatës Supreme të Kosovës do t'i shtjelloj këto çështje në kontekstin e procedurës aktuale përderisa çështjet e ngritura janë paragjyquese të ligjshmërisë së aktvendimit të kundërshtuar. Përndryshe, gjykata nuk mund të jap mendime/vendime të përgjithshme të cilat duhet të promovojnë zbatimin unik të KPPK-së. Kjo e drejtë është e rezervuar për Seancën e Përgjithshme të Gjykatës Supreme sipas nenit 23, paragrafit 1 të Ligjit mbi Gjykatat.
34. Çështja e kërkesës para këtij kolegji është nëse aktvendimi i kundërshtuar ka shkelur KPPK-në duke hedhur poshtë aktakuzën si të paafatshme, sepse është paraqitur pas skadimit të afati 2 vjeçar sipas nenit 159, paragrafit 1 të KPPK-së. Shkelja do të cilësohej sipas nenit 384, paragrafit 2, nën-paragrafit 2.1, propozimi i dytë i KPPK-së.
35. Për t'iu përgjigjur kësaj pyetje, ky kolegji ka bërë një shqyrtim sistematik të KPPK-së duke i lexuar të gjitha dispozitat që lidhen me faza të ndryshme të procedurës penale siç janë përcaktuar në KPPK-ë.
36. Së pari, neni 68 i KPPK-së përcakton katër faza të ndryshme të procedurës penale, siç është vërejtur me të drejtë edhe nga Gjykata e Apelit. Këto janë hetimi, aktakuza dhe deklarimi, shqyrtimi gjyqësor dhe mjeti juridik. Procedurës penale formale i paraprijnë hapat fillestar të ndërmarrë nga Policia apo mbledhja e informatave sipas nenit 84 të KPPK-së, që është fazë e veçantë. Prandaj, KPPK-ja formalisht definoi se hetimi dhe aktakuza janë dy faza të ndara të procedurës penale.
37. Së dyti, hetimi dhe ngritja e aktakuzës ndryshojnë jo vetëm në aspektin formal në bazë të strukturës së dispozitave të Kodit të Procedurës, por gjithashtu edhe në thelbin e tyre. Pragu i dyshimit për ngritjen e aktakuzës është më i lartë se sa për fillimin e hetimit. Neni 102 i KPPK-së kërkon vetëm dyshimin e arsyeshëm për fillimin e hetimit, ndërsa pragu për ngritjen e aktakuzës sipas nenit 240 të KPPK-së është dyshimi i bazuar.
38. Së treti, sipas nenit 159, paragrafit 1 të KPPK-së, siç është vërejtur me të drejtë nga Gjykata e Apelit, me mbarimin e periudhës 2 vjeçare të hetimit, nëse nuk ndërpritet nga Prokurori ai ndërpritet *ex-lege*. Megjithatë, edhe këtu shumica e kolegjit nuk pajtohet me Gjykatën e Apelit, kjo nuk përjashton të drejtën procedurale të prokurorit që të ngit aktakuzë. Argumenti sistematik duhet gjetur në dispozitën e nenit 240 *ibid* i cili përcakton se aktakuza ngritet pas përfundimit të hetimit. Ligji nuk e ndalon prokurorin të paraqesë aktakuzë pasi hetimi është përfunduar/ndërprerë *ex-lege*. Përfundimi logjik do të ishte se e drejta procedurale e prokurorit për të ngritur aktakuzë pamundësohet dhe është e

pakthyeshme pas skadimit të afatit të parashkrimit të përcaktuar me ligjin material penal. Në lëndën në fjalë, do të ishte neni 106 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

39. Shumica e kolegjit pajtohet me arsyetimin e dhënë nga Gjykata e Apelit i përdorur si aktvendim referencë, i datës 15 gusht 2013, në lëndën me numër 543/2013, që aktakuza duhet të ngritet menjëherë, "mundësisht brenda ditëve pas hetimit" (paragrafi 70 i aktvendimit në fjalë). Kjo, për shkak se çdo vonesë rrit rrezikun, se e drejta e të pandehurit për një gjykim të drejtë brenda kohës së arsyeshme, mund të shkelet. Në rast në të ardhmen do të thirren në një shkelje të tillë, në qoftë se ndodh ndonjëherë, arsyeshmëria e kohëzgjatjes së procedurës duhet të vlerësohet në bazë të rrethanave të veçanta të lëndës (kryesisht në kompleksitetin e saj), dhe në qoftë se do të kishte vonesa të tepruara, do të ishte detyrë e Prokurorisë që t'i sqaroj ato. Përveç kësaj, përsëri në mënyrë hipotetike, nëse procedura penale (çfarëdo procedure penale, përveç atyre që lidhen me krime lufte dhe krime të tjera sipas të drejtës ndërkombëtare humanitare), do të do të zgjaste në mënyrë të pajustificueshme dhe nëse procedura e tillë përfundon me një vendim mbi dënimin, vetë kohëzgjatja do të cilësohej si rrethanë lehtësuese.
40. Sidoqoftë, kjo nuk është një çështje e cila duhet të merret parasysh në këtë moment. Së pari, për shkak se formalisht aktakuza nuk është e paafatshme dhe së dyti nëse është "tepër e vonë", që është paraqitur rreth afërsisht 3 muaj pas skadimit të hetimit, nuk mund të argumentohet në mënyrë të arsyeshme se gjykimi i drejtë më tutje nuk është i mundur.
41. Shumica e kolegjit ndan mendimin se, në mënyrë që të shmangen vonesat e tepruara në ngritjen e aktakuzës, *de lege ferenda*, ligjvënësi mund të vendos kohën prekluzive për ngritjen e aktakuzës, pas ndërprerjes së hetimit. Sidoqoftë, ligji siç është tani (*lex lata*) nuk e parasheh që aktakuza detyrimisht të ngritet para përfundimit të kohës së hetimit në mënyrë që të jetë "me kohë". Prandaj, ky kolegji, në shumicën e tij nuk pajtohet me nocionin aktakuzë e "paafatshme".
42. Për arsyet e lartpërmendura, shumica e kolegjit nuk pajtohet me mendimin e shprehur në lidhje me këtë në qarkoren e nënshkruar nga Kryetari i Gjykatës Supreme të 19 janarit 2015. Qarkoja është lëshuar gjoja nën premisat e nenit 23 të Ligjit mbi gjykatat i cili i mundëson Seancës së Përgjithshme të Gjykatës Supreme të lëshojë mendime/vendime për unifikimin e zbatimit të ligjit. Qarkorja përmban mendimin e Kryetarit të Gjykatës Supreme dhe padyshim reflekton qëndrimin e shprehur nga seanca e përgjithshme e Gjykatës Supreme. Sidoqoftë, anëtarët e këtij kolegji e respektojnë lart. Megjithatë, shumica nuk e konsideron si ligjërishit detyrues dhe nuk pajtohet me atë.
43. Paneli pajtohet me mbrojtjen se dispozita në lidhje me kohëzgjatjen e hetimit është prekluzive, respektivisht e pandryshueshme. Hetimi ndërpritet *ex lege* pas skadimit të periudhës së hetimit. Kjo është e vërtetë, sepse në një rast të tillë, të drejtat e të pandehurit preken në një mënyrë të veçantë. Që do të thotë, me fjalë të tjera, asnjë veprim hetimor

nuk mund të merret nga prokurori, pas skadimit të periudhës së hetimit. Neni është shumë i qartë sa i përket afateve kohore të fazës së hetimit. Sidoqoftë, nuk e detyron, siç u sqarua më lart, që aktakuza patjetër të ngritet brenda afateve të hetimit.

44. Paneli është në dijeni të dispozitës së nenit 438, paragrafin 2 të KPPK-së e cila përcakton se kur Gjykata Supreme gjen se kërkesa e paraqitur për mbrojtjen e ligjshmërisë në dëm të të pandehurit është e bazuar, vetëm konstaton shkeljen e ligjit pa ndikuar në vendimin e formës së prerë. Dispozita duhet të lexohet në mënyrë sistematike në lidhje me nenin 436 paragrafin 3 dhe nenin 395 të KPPK-së. I pari përcakton që Gjykata në kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë do të detyrohet me ndalesën *reformatio në peius* në bazë të nenit 395, kur kërkesa është në dobi të të pandehurit (që në këtë rast nuk vlen). Ky i fundit formulon çfarë përfshin përmbajtja e ndalimit *reformatio në peius*, që është se në rast të një vendimi të dënimit ky i fundit nuk mund të ndryshohet në lidhje me cilësimin juridik të veprës dhe sanksionit penal të shqiptuar. Asnjëra nga këto çështje, cilësimi dhe / ose dënimit nuk është objekt i shqyrtimit aktual (dhe kolegji nuk do të shtjellojë nëse kjo në përgjithësi do të ishte e mundur me kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë) prandaj nuk ka asnjë pengesë për kolegjin që të veprojë sipas nenit 438, paragrafit 1, nën-paragrafit 1.1 të KPPK-së. Përveç kësaj, shumica e kolegjit arriti në përfundimin se për aq kohë sa të pandehurit janë të mbrojtur me prezumimin e pafajësisë nuk mund të konsiderohet se ata janë vënë në një pozitë të pafavorshme. Aq më tepër, ata do ta kenë mundësinë që pafajësisë së tyre t'i jepet një sanksionim më i lartë nga vendimi mbi meritat e lëndës dhe të lirohen nga të gjitha akuzat.

C. Përfundim

Aktvendimi i kundërshtuar i Gjykatës së Apelit PN 365/15, i datës 5 gusht 2015, ndryshohet për të pranuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të datës 9 shtator 2015. Aktakuza nuk është e paafatshme. Lënda kthehet në Gjykatën Themelore të Prishtinës në mënyrë që kryetari i trupit gjykues të procedojë në përputhshmëri.

Kolegji ka marrë këtë vendim sipas nenit 435 të KPP-së vetëm në bazë të kërkesave dhe propozimeve të paraqitura, përkatësisht nenit 384 paragrafit 2, nën-paragrafit 1 të KPPK-së, në lidhje me nenin 159 *ibid*, siç është thirrur Prokurori. Sa për sqarim, kolegji nuk ka gjetur asnjë shkelje të nenit 384 paragrafit 1 nën-paragrafit 12 në lidhje me nenin 370 të KPP-së. Kolegji konstaton se çështjet nën shqyrtim janë të qarta që e bëjnë seancën e kolegjit të panevojshme. Në bazë të arsyeve të cekura më lart, është vendosur si në dispozitiv.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

PRISHTINË

PML-KZZ-242/15

Kryetare e kolegjit
Elka Filcheva-Ermenkova,
Gjyqtare e EULEX-it

Procesmbajtës

Adnan Isufi

Këshilltar ligjor i EULEX-it

Anëtarët e kolegjit

Dariusz Sielicki
Gjyqtar i EULEX-it

Avdi Dinaj

Gjyqtar i Gjykatës Supreme

Republika e Kosovës  Republika Kosovo
SARINJINË E KOPJES E VERIFITON
TAČNOSTI OTPRAVKA PODRUČJE

Prokuror autorizuar
Dyqëndror radnik

